



Shtatzënë?

Bëni vaksinat tuaja kundër COVID-19

Vaksinimi kundër COVID-19 rekomandohet plotësisht për gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë me gji

Vaksinat e COVID-19 të disponueshme në MB kanë treguar të jenë efektive dhe të kenë një profil të mirë sigurie. Është e rëndësishme që të bëni vaksinat tuaja kundër COVID-19 për të mbrojtur veten dhe fëmijën tuaj.

VAKSINIMI KUNDËR COVID 19 në shtatzëni

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka këshilluar tani që gratë shtatzëna janë më të rrezikuara nga sëmundja e rëndë e COVID-19. Ata po u kujtojnë grave shtatzëna që të bëjnë vaksinat e tyre për COVID-19 sa më shpejt të jetë e mundur. Ato nuk duhet ta shtyjnë vaksinimin deri pas lindjes. Kjo është për t'i mbrojtur ato dhe foshnjat e tyre. Në MB, mbi 100 000 gra shtatzëna janë vaksinuar kryesisht me vaksinat Pfizer dhe Moderna dhe ato kanë një profil të mirë sigurie.

Këto vakcina nuk përmbajnë koronavirus të gjallë dhe nuk mund të infektjnë një grua shtatzënë ose foshnjën e saj të palindur në mitër.

Dëshmitë për vaksinat kundër COVID-19 po shqyrtohen vazhdimisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) (World Health Organization (WHO)) dhe organet rregullatore në MB, SHBA, Kanada dhe Evropë.

Vaksinat Pfizer dhe Moderna janë vaksinat e preferuara për gratë shtatzëna të çdo moshë që vijnë për dozën e tyre të parë.

Kushdo që ka filluar tashmë vaksinimin dhe i është ofruar një dozë e dytë gjatë shtatzënisë, duhet të marrë një dozë të dytë me të njëjtën vaksinë, përveç nëse ka pasur një efekt anësor serioz pas dozës së parë.

Mësoni më shumë rreth shtatzënisë, ushqyerjes me gji, fertilitetit dhe vaksinimit kundër koronavirusit (COVID-19) në faqen e internetit të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (NHS)

Pse më duhet vakcina nëse jam shtatzënë?

Nëse keni sëmundjen e COVID-19 në muajt e fundit të shtatzënisë, si ju ashtu edhe foshnja juaj e palindur jeni në rrezik të shtuar të sëmundjeve serioze që kërkojnë trajtim spitalor dhe mbështetje të kujdesit intensiv. Të dhënat në Mbretërinë e Bashkuar kanë treguar se pothuajse çdo grua shtatzënë me sëmundjen e COVID-19 që kishte nevojë për trajtim spitalor ose kujdes intensiv, nuk ishte vaksinuar. Rreziku i përgjithshëm nga sëmundja e COVID-19 për ju dhe foshnjën tuaj të re është i ulët, por është rritur që nga valët e para të COVID-19.

Vaksinat kundër COVID-19 në shtatzëni ju japin nivele të larta mbrojtjeje kundër sëmundjes. Ka informacione qetësuese për sigurinë e vaksinave të COVID-19 që u jepen grave shtatzëna në MB, si dhe vende të tjera.

Është e rëndësishme që të jeni të mbrojtur me të gjitha dozat tuaja të vaksinës për të mbajtur veten dhe fëmijën tuaj të sigurt. Mos prisni derisa të keni lindur.

Gratë shtatzëna me sëmundje themelore klinike janë në rrezik më të lartë për të vuajtur komplikime serioze nga COVID-19.

Faktorët e rrezikut për gratë shtatzëna

Nëse keni gjendje themelore shëndetësore si:

- probleme me imunitetin
- diabeti
- tensioni i lartë i gjakut
- sëmundje të zemrës
- astma

Ose nëse jeni

- mbipeshë
- mbi 35 vjeç
- në tremujorin e tretë të shtatzënisë (mbi 28 javë)
- me prejardhje etnike të minoritetit të zi ose aziatik
- ose mbeteni të pavaksinuar ose pjesërisht të vaksinuar

Ju jeni më të rrezikuara nga COVID-19 sesa gratë e së njëjtës moshë që nuk janë shtatzënë.

Çfarë do të thotë kjo për mua?

Të mbetesh shtatzënë

Nuk ka nevojë të shmangni shtatzëninë pas vaksinimit kundër COVID-19.

Nuk ka asnjë provë që vaksinat e COVID-19 të kenë ndonjë efekt mbi fertilitetin ose shanset tuaja për të mbetur shtatzënë.

Nëse jeni shtatzënë

Vaksinat kundër COVID-19 u ofrojnë grave shtatzëna mbrojtjen më të mirë kundër sëmundjes së COVID-19 e cila mund të jetë serioze në muajt e fundit të shtatzënisë për disa gra.

Doza e parë e vaksinës së COVID-19 do t'ju japë mbrojtje të mirë. Ju duhet të merrni secilën nga dozat tuaja në kohë për të marrë mbrojtjen më të mirë të mundshme. Dozën e dytë duhet ta merrni 8 deri në 12 javë pas dozës së parë. Ju nuk keni nevojë ta vononi këtë dozë të dytë. Nëse e keni vonuar vaksinimin për ndonjë arsye, bëni vaksinat sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse e keni marrë tashmë një dozë të parë të vaksinës së COVID-19 pa pësuar ndonjë efekt anësor serioz, mund të merrni dozën e dytë me të njëjtën vaksinë kur kjo të ofrohet.

Nëse doza juaj e parë ishte vakcina AstraZeneca, duhet të merrni parasysh gjithashtu informacionin në këtë broshurë www.gov.uk/government/publications/covid-19-vaccination-and-blood-clotting.

Vaksinat përforcuese

Gratë shtatzëna kanë të drejtë për një përforcues, 12 javë pas dozës së dytë. Doza përforcuese që ofrohet mund të jetë një vaksinë Pfizer ose Moderna.

Asnjë vaksinë nuk është 100% efektive, kështu që është e rëndësishme të vazhdohet të ndiqni udhëzimet aktuale kombëtare.

Për të mbrojtur veten dhe familjen, miqtë dhe kolegët tuaj, ju ende DUHET:

- të vini një maskë për fytyrën, aty ku këshillohet
- t'i lani duart me kujdes dhe shpesh
- të hapni dritaret për të lejuar ajrin e pastër
- të ndiqni [udhëzimet aktuale](#)

Ushqyerja me gji

Përfitimet e ushqyerjes me gji janë të njohura.

Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (JCVI) ka rekomanduar që vaksinat të mund të merren gjatë ushqyerjes me gji. Kjo është në përputhje me rekomandimet e SHBA-së dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Ashtu si të gjitha barnat, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore të zakonshme. Mund të jetë e dobishme të siguroheni se çfarë të prisni pasi të keni bërë vaksinën, veçanërisht nëse keni lindur fëmijën tuaj ose keni fëmijë të tjerë për t'u kujdesur.

Ju lutemi lexoni broshurën "çfarë të presësh pas vaksinimit kundër COVID" www.gov.uk/government/publications/covid-19-vaccination-what-to-expect-after-vaccination.

Kolegji Mbretëror i Obstetërve dhe Gjinekologëve (RCOG) dhe Kolegji Mbretëror i Mamine (RCM) kanë një udhëzues vendimi dhe informacione të tjera që mund t'i gjeni të dobishme për vaksinat kundër COVID-19 dhe shtatzëninë (rcog.org.uk – www.rcm.org.uk/guidance-for-pregnant-women).

Nëse dëshironi të diskutoni rreth vaksinimit kundër COVID-19, ju lutemi kontaktoni maminë, mjekun ose infermierën tuaj.

Mos e shtyni vaksinimin deri pasi të keni lindur, gjeni kohë për të marrë mbrojtjen më të mirë që kemi kundër sëmundjes së COVID-19 për ju dhe fëmijën tuaj.

Vaksinimi, ndihmon në mbrojtjen e atyre që janë më të cenuar.



Kjo fletëpalosje falas është gjithashtu e disponueshme në shkrimin Braj, si video në BSL, printim të madh, si një skedar audio me zë dhe në 27 gjuhë, ju lutemi vizitoni www.healthpublications.gov.uk për të shkarkuar ose për të porositur kopje tani. Ose telefononi në 0300 123 1002 për të porositur.